

VENDIM
Nr.845, datë 6.12.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR KUÇOVË-BELSH-CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kuçovë - Belsh - Cërrik.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë arë me sipërfaqe 8808 (tetë mijë e tetëqind e tetë) m², me vlerë 2 202 000 (dy milionë e dyqind e dy mijë) lekë; objekt me sipërfaqe 50 (pesëdhjetë) m², me vlerë 2 534 817 (dy milionë e pesëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë; objekt “pikë karburanti”, me nr/pas. 121/7/1, me vlerë 5 303 427 (pesë milionë e treqind e tre mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë; kultura bujqësore dhe dru frutorë, me vlerë 361 380 (treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e treqind e tetëdhjetë) lekë dhe truall me sipërfaqe 268 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) m², me vlerë 160 800 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind) lekë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 030 000 (një milion e tridhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 562 424 (dhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e njëzet e katër) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit për programin “Rrugët nacionale”.

5. Pronarët e listave që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur, brenda afateve ligjore, dokumentacionin e plotë të pronësisë, të rifreskuar, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

6. Pronari i objektit të cilit i është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, të likuidohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të pezullojnë të gjitha transaksionet me pronarët e pasurive të shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe

zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha